

#NDRIÇOJE BOTËN

Në 25 Mënyra. Gjatë 25 Ditëve.

Gjatë krishtlindjes, na kujtohet që Jezu Krishti është drita e botës. Këtë vit, ne kemi një mundësi të mrekullueshme për ta shpërndarë atë dritë duke zgjedhur që të bëjmë gjërat që bëri Jezu Krishti. Çdo ditë që na çon drejt krishtlindjes, ne do të përqendrohemi te një sjellje e ndryshme e ngjashme me të Krishtit dhe do të japim sugjerime për mënyra në të cilat mund t'i përngjajmë shembullit të Tij. Ju nxiteni të merrni pjesë, duke përdorur skicën më poshtë ndërsa i planifikoni veprimtaritë e krishtlindjes për bashkësinë tuaj.

DITA
1

Jezusi i Ngriti
Barrët e të Tjerëve
dhe Kështu Mund
të Bëni edhe Ju

FILLIMI I NGJARJES:

**DITA
MBARËBOTËRORE
E
SHËRBIMIT**

DITA
2

Jezusi i Nderoi
Prindërit e Tij dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Telefonojini (jo t'u dërgoni mesazh me celular) prindërve tuaj.
- Shkruajuni një shënim me dorë prindërve tuaj ose prindërve të bashkëshortit/es.
- Mësoni rreth një paraardhësi dhe tregojeni historinë e tij. Për ndihmë, provojeni faqen FamilySearch.org.

DITA
3

Jezusi e Adhuroi
Atin e Tij dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Merrni pjesë në një shërbim të Kishës në zonën tuaj – jeni gjithmonë të ftuar në njërin prej shërbimeve tona.
- Bëjeni synim që të ofroni çdo ditë në dhjetor një lutje në gjunjë drejtuar Atit Qiellor.
- Ndihmoni për të pastruar ose mirëmbajtur një ndërtesë të Kishës.

DITA
4

Jezusi i Ndihmoi të
Tjerët të Shikonin
dhe Kështu Mund
të Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Gjeni një vend grumbullimi syzesh dhe dhuroni një palë syze të vjetra [për nevojtarët].
- Vëri në dukje dikujt një virtut që ai/ajo nuk e sheh te vetja.
- Përkraheni një ngjarje bamirësie për problemet me shikimin në median shoqërore. Mund të përdorni edhe simbolin [emoji] e syzeve.

DITA
5

Jezusi i Shëroi
të Sëmurët dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Regjistrohuni për të qenë një dhurues organesh.
- Dhuroni gjak në një bankë vendore dhurimi të gjakut.
- Zgjidhni që të luteni përditë për njerëzit tuaj të dashur që janë sëmurë ose po vuajnë.

DITA
6

Jezusi i Lexoi
Shkrimet e Shenjta
dhe Kështu Mund
të Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Vendoseni alarmin tuaj 15 minuta më përpara për studimin e shkrimeve të shenjta.
- Publikojeni shkrimin tuaj të parapëlqyer në median shoqërore.
- Çojani me mesazh një shkrim të shenjtë dikujt që mund të ketë nevojë për t'i dhënë zemër.

DITA
7

Jezusi i Ushqeu
të Uriturit dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Dhuroni artikuj që nuk prishen, në një depo ushqimesh në zonën tuaj.
- Ftojini për darkë një fqinj që është ngushtë ekonomikisht.
- Mësoni rreth ngopjes së urisë shpirtërore.

DITA
8

Jezusi na Mësoi të
Lutemi

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Mendoni për një mik që po kalon disa sfida të rënda. Thoni një lutje për të.
- Pyeteni Perëndinë se si mund të jeni përgjigjja për lutjen e dikujt tjetër.
- Kur ishte hera e fundit që u lutët me familjen tuaj? Po sikur të luteni pikërisht tani?

DITA
9

Jezusi i Vizitoi të
Vetmuarit dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Vizitoni një azil. Studimet tregojnë se 60% e personave nuk kanë asnjëherë vizitorë gjatë qëndrimit të tyre.
- Ftojini një burrë ose grua të ve për darkë.
- Identifikojeni dikë që do të jetë i/e vetëm/vetme për krishtlindje. Ftojini ata të marrin pjesë në një shërbim në Kishë me ju Ditën e Krishtlindjes.

DITA
10

Jezusi i Ndihmoi
Njerëzit të Ecnin
dhe Kështu Mund
të Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Mësoni më shumë rreth programit shdm për karriget me rrota.
- Dhurojani patericat, karriget me rrota ose mbajtëset tuaja të vjetra për ecje një grupi që i riparon ato.
- Planifikoni një veprimtari për një mik invalid që u përshtatet aftësive të tij/saj.

DITA
11

Jezusi u Dha
Shërbesë Fëmijëve
dhe Kështu Mund
të Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Pyetini fëmijët tuaj për çfarë mendojnë se mund të luteni si familje
- Si dhuratë krishtlindjeje, blini një pikturë të Jezu Krishtit për dhomën e fëmijës suaj. Mësojini fëmijës suaj rreth dashurisë së Shpëtimtarit për të.
- Lini një natë në javë vetëm për ju me fëmijët tuaj.

DITA
12

Jezusi u Dha
Mësim të Tjerëve
dhe Kështu Mund
të Bëni edhe Ju

DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:

- Shpërndajeni mësimin ose historinë tuaj të parapëlqyer të Jezusit në median shoqërore.
- Kalojuani fëmijëve tuaj diçka që e mësuat nga prindërit ose gjyshërit tuaj.
- Shikoni një material filmik udhëzues në internet për të mësuar aftësi të reja që mund t'u sjellin dobi të tjerëve.

DITA
13**Jezusi Tregoi
Përulësi dhe Kështu
Mund të Bëni edhe
Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Tregojani një përvajë njerëzve tuaj të dashur rreth një kohe kur ju duhej të mbështeteshit në ndihmën e Perëndisë.
- Pavarësisht nga mosha juaj, pyeteni një prind se si t'ia bëni për një sfidë të tanishme në jetën tuaj.
- Mendoni rreth një rasti kur u gabuat për dikë. Tregojani atë një njeriu të dashur.

DITA
14**Jezusi Na Mësoi t'i
Veshim të Zhveshurit
dhe Kështu Mund të
Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- A keni blerë veshje të reja kohët e fundit? Dhurojini disa veshje të vjetra për bamirësi ose në një dyqan bamirësie për veshje të përdorura.
- Mblidhni veshje dimri (të vjetra ose të reja) për strehën tuaj vendore të të pastrehëve.
- Mësojeni nga një mbret i mençur se si duhet t'i duam ata që janë në nevojë. (Mosia 4:14–27)

DITA
15**Jezusi Adhuroi
Nëpërmjet Këngës
dhe Kështu Mund
të Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Ftojini një mik që të marrë pjesë në shërbimin e adhurimit Ditën e Krishtlindjes për të kënduar himne dhe për ta adhuruar Perëndinë.
- Shpërndajeni interpretimin tuaj të parapëlqyer të një himni krishtlindjeje në median shoqërore.
- Dëgjoni himne krishtlindjeje një ditë të tërë.

DITA
16**Jezusi Tregoi
Dhembshuri dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Bëhuni dhurues, në një program vendor bamirës “Zëvendës të Plakut të Dhuratave”, për një familje që do t'i duhej pak gëzim për festa.
- Provojeni të lini vetëm komente zemërdhënëse në median shoqërore.
- Lutuni për një mundësi sot që t'i tregoni dhembshuri dikujt.

DITA
17**Jezusi e Nderoi
Shabatin dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Fikeni telefonin tuaj për disa orë sot.
- Merrni pjesë në një shërbim fetar në zonën tuaj.
- Vizitoni një pjesëtar të familjes.

DITA
18**Jezusi u Kujdes për
Nënë e Tij dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Merreni në telefon nënën tuaj pikërisht tani.
- Bëni një listë të të gjitha gjërave që ka bërë nëna juaj për ju. Dërgojani atë asaj.
- Përcaktoni një figurë amënore në jetën tuaj dhe çojini lule asaj.

DITA
19**Jezusi e Qetësoi
Stuhinë dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Mësoni mënyra se si mund t'i ndihmoni njerëzit anekënd botës nëpërmjet dhënies për bamirësi.
- Shqyrtojini planet për reagimet ndaj përmbytjeve për njerëzit që jetojnë në zonën tuaj.
- Jepini si dhuratë familjes suaj ose njerëzve tuaj të dashur kompletin [e ndihmës] për 72-orë për raste urgjencash.

DITA
20**Jezusi Pa Potencial
tek të Tjerët dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Jini një mësues/ndihmës për dikë.
- Merreni me vete fëmijën në punën tuaj dhe lëroni të bëjë një pjesë të vogël të punës suaj.
- Jepini zemër dikujt! Merrni pjesë në një veprimtari (atletike, kulturore etj.) për të përkrahur dikë që e njihni.

DITA
21**Jezusi na Mësoi t'i
Falim të Tjerët****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- A ka ndonjë pjesëtar të familjes me të cilin nuk keni folur kohët e fundit? Merreni në telefon.
- Bëni një listë të mërive tuaja. Pastaj bëni plane që të hiqni dorë prej tyre.
- Shpërndajeni këtë material filmik frymëzues rreth faljes së gjërave në dukje të pafalshme.

DITA
22**Jezusi Tregoi
Mirënjohje dhe
Kështu Mund të
Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Jepini një dhuratë të thjeshtë postierit tuaj për t'i ngritur humorin gjatë periudhës së tyre më të ngarkuar me punë.
- Bëni një lutje mirënjohjeje të pastër. Pa kërkesa. Thjesht falënderime.
- Shkruajini një letër falënderimi dikujt që ka ndikuar për mirë në jetën tuaj.

DITA
23**Jezusi ishte
Paqebërës dhe Ju
Mund të Jeni i Tillë****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- A duhet t'i kërkoni ndjesë dikujt? Merrni vendimin për të vepruar.
- Bëni një dhurim për të ndihmuar refugjatët nga rajonet e shkatërruara nga lufta.
- Sot thoni gjëra të këndshme për të tjerët pas shpinës së tyre.

DITA
24**Jezusi u Kujdes për
Njerëzit e Tij të Dashur
dhe Kështu Mund të
Bëni edhe Ju****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Planifikoni një program të veçantë për Vigjiljen e Krishtlindjes me familjen dhe miqtë tuaj.
- Lini një dhuratë anonime për një pjesëtar të familjes.
- Gjeni një çast për t'i shkruar ditëlindjet e të gjithë miqve tuaj në telefonin tuaj celular.

DITA
25**Dishepujt e Jezusit
e Ndoqën Atë dhe
Kështu Mund të Bëjmë
edhe Ne****DISA MËNYRA PËR T'U PËRFSHIRË:**

- Kthejini disa nga idetë për 25 Ditë nga ky muaj në qëllime vjetore të Vitit të Ri.
- Gjeni një pikturë të Jezu Krishtit që ju frymëzon dhe vendoseni në shtëpinë tuaj ku mund të shërbejë si një kujtues.
- Shihni disa pjesë të spikatura për mënyrën se si të tjerët e ndoqën Jezu Krishtin gjatë kësaj periudhe krishtlindjeje.

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME**mormon.org**